Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-548
Datë 18.10.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2018 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Validohet dhe akreditohet UNI BB Sh.P.K me tri nën- qendra, qendra kryesore me adresë në Prishtinë, rruga Mehmet Gradica kati 1, nr. 12, nën- qendra në Ferizaj, me adresë, rruga Fan Noli, nr.156, nën- qendra në Prizren me adresë, rruga Rruga Rexhep Kabashi, nr.39 dhe nën-qendra në Pejë, me adresë Rruga e TMK, nr.14, për periudhën 05.10.2018 deri 05.10.2021 me kualifikimet:

   1.1. Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjajshëm, Niveli IV sipas KKK me 22 kredi të AAP.

   1.2. Rrobaqepësi, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjajshëm, Niveli III sipas KKK me 24 kredi të AAP.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose

Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.
Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

2. Vendimi i dërgohet:

   - UNI BB Sh.P.K në Prishtinë; dhe
   - AKK.

Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema